

## MBLIDHET KOMISIONI I PAVARUR AD HOC PËR ANËTARËT E KLGJ DHE KLP NGA RADHËT E AVOKATISË

Referuar nenit 26 dhe 124 të nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Avokati i Popullit, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Pavarur Ad Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatisë, thirri sot mbledhjen e dytë të tij ditën e enjte, datë 07.09.2023, ora 09.00, pranë zyrave të Avokatit të Popullit.

Pjesëmarrës në mbledhje ishin: Erinda Ballanca, Avokate e Popullit në cilësinë e Kryetarit, ndërsa në cilësinë e anëtarëve: Sandër Simoni, Shaban Sinani, Maksim Haxhia dhe Ilir Dode. Në mbledhje kishte gjithashtu pjesëmarrës nga partnerët ndërkombëtarë, në cilësinë e vëzhguesit, konkretisht nga OPDAT dhe nga Projekti EU4Justice.

Gjatë mbledhjes u zhvilluan diskutime lidhur me rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Ad-Hoc si dhe me procedurat që do të ndiqen për verifikimin e disa kriterëve specifike të parashikuara nga ligji.

Komisioni është i dedikuar ta realizojë këtë proces me profesionalizëm dhe integritet për të siguruar zgjedhjen e kandidatëve mbi bazë merite.